

Tiranë më, 17.09.2019

KALLËZIM PENAL

- KALLËZUES:** Shoqëria "Gjoka Konstruksion" sh.a, e regjistruar me vendim të Gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë me vendim nr. 3306 datë 01.04.1994, e regjistruar në QKR, me nr. NIPT J91815014U, me adresë Rruga "Dora D'Istria" Hyrja 1&2, Tiranë, me aksioner të vetëm z. Rrok Gjoka i biri i Kolës, i datëlindjes 04.01.1951, lindur në Pukë dhe banues në Tiranë, me dokument identifikues leternjoftim ID nr 027554655 dhe nr personal F10204114F me numër cel. 0692027997 dhe e-mail: info@gjoka.al
- I KALLËZUAR:** zj. Sonila QATO me detyrë Drejtor i përgjithshëm i Autoritetit Rrugor Shqiptar me adresë Adresa rruga Sami Frasheri, nr 33, Tirane me numër tel. 00355 4 223 44 87 dhe email: info@arrsh.gov.al
- OBJEKTI:** Kallzim penal për kryerjen e veprës penale të
-"Shperdorimit te detyres",parashikuar si e tille nga Neni 248 i K.P
-"Kryerjen e veprimeve arbitrare", parashikuar nga Neni 250 i K.P
-"Shkelje e barazise se shtetasve",parshikuar nga Neni 253 i K.Penal
-"Shkelje e barazise pjesmarresve ne tendera apo ankande publike" parashikuar si e tille nga Neni 258 i K.Penal.
-"Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike" parashikuar si e tille nga Neni 259 i K.Penal.
- DREJTUAR:** PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË KRIMEVE TË RËNDA
- BAZA LIGJORE:** Nenet 248, 250, 253, 258 dhe 259 të Kodit Penal dhe 280 e vijues të Kodit të Procedurës Penale

I Nderuar z. Prokuror,

Në zbatim të Neneve 280 e vijues të Kodit të Procedurës Penale dhe neneve 248, 250, 253, 258 dhe 259 të Kodit Penal, duke qenë se kjo çështje hyn në juridiksionin



tuaj në mbrojtje të interesave të ligjshme të shoqërisë që përfaqësoj, shtetit të së drejtës, parimit të sigurisë juridike ju parashtroj si më poshtë:

Rrethanat dhe faktet e çështjes:

Shoqëria "Gjoka Konstruksion" sh.a është person juridik i krijuar që në vitin 1994, i regjistruar pranë QKR me NIPT J91815014U dhe kod Fiskal 3708547 me seli kryesore në adresën rruga "Dora D'Istria", Hyrja 1&2, Tiranë, e cila ka si objekt kryesor të veprimtarisë së saj ndërtimet civile. Kjo shoqëri kryen aktivitetin e saj bazuar në kontrata të lidhura me subjekte private vendas dhe të huaj si edhe mbi bazën e kontratave të lidhura me ente publike të fituara sipas ligjit për prokurimin publik, dhe jo vetëm.

Në funksion të veprimtarisë që ushtron në fushën e ndërtimit, shoqëria "Gjoka Konstruksion" sh.a ka marrë pjesë si anëtare e bashkimit të operatorëve ekonomik në formën e JV në tenderin me objekt "Ndërtimi i rrugës Kardhiq-Delvinë Lot 7" më datë 17.06.2019, të zhvilluar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar në rolin e Autoriteti kontraktor.

Pas dhënies së ofertës, më datë 20.09.2019 jemi njoftuar për Vendimin e marrë nga Autoriteti Rrugor Shqiptar për skualifikimin tonë nga procedura e prokurimit. Skualifikimi është ankimuar nga ne në Komisionin e Prokurimit Publik, i cili me Vendimin 510/2019 datë 01.08.2019 ka urdhëruar ARrSh të rregulloj shkeljen e kryer dhe të kualifikojë kompaninë tonë. Vendimi i KPP, organ të cilin Ligji i prokurimit publik e ka përcaktuar si organin më të lartë për shqyrtimin e ankesave në fushën e prokurimit publik, i është dorëzuar palëve më datë 05.08.2019 me postë me detyrimin për zbatim brenda 10 ditëve nga ARrSh.

Në datë 13.08.19 vetëm 2 ditë para skadimit të afatit për zbatimin e Vendimit të KPP, Drejtori i ARrSh nxjerr Urdhër për verifikim të zbatimit të punimeve të kontratës të dorëzuar si punë e ngjashme në këtë procedurë nga "Gjoka Konstruksion" sh.a. Këto punime në vlerësimin e bërë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk kanë qënë arsye skualifikimi dhe **as janë ngritur në asnjë çast dyshime në lidhje me vërtetësinë e këtyre punimeve.**

Në datën 16.08.2019 Autoriteti Kontraktor ka kërkuar rishikimin e Vendimit 510/2019 të KPP, kërkesë e cila nuk është pranuar me Vendimin 510/4/2019 datë 20.08.2019 të K.P.P, dhe ka lënë në fuqi Vendimin 510/2019, të detyrueshëm për zbatim nga Autoriteti Kontraktor.

Më datë 28.08.219, ora 11:55 Autoriteti kontraktor ka zbatuar Vendimin 510/2019 të K.P.P në sistem, ndërsa ka vijuar që më datë 02.09.2019 K.V.O të kryejë



rivlerësimin e procedurës dhe ka refuzuar ofertën tonë duke arsyetuar se pas shqyrtimit të ankesës nga operatori BOE "Ircop" S.p.a & "Sulova Ndërtim Prodhim" & "Vega" & "A&E Engineering" perfaqësuar nga shoqëria "Sulova Ndërtim Prodhim" sh.p.k lidhur me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik Gjoka Konstruksion sh.a, si dhe raportit të inspektimit të grupit të specialistëve të ngritur me urdhër të titullares së AK për inspektimin dhe verifikimin në terren të punëve të deklaruara të përfunduara nga Gjoka Konstruksion sh.a, rezulton se: **Dokumentacioni i paraqitur nga operatori Gjoka Konstruksion sha paraqet të dhëna të rreme e të pasakta.**

Për të intimiduar shoqërinë Gjoka Konstruksion sh.a, drejtoresha e Autoritetit Rrugor Shqiptar ka ngritur një grup pune joprofesional për inspektim punimesh zbatimi me arkitektë dhe juriste.

Në lidhje me rivlerësimin dhe skualifikimin e kryer për së dyti herë më datë 02.09.2019 Gjoka Konstruksion sh.a ka paraqitur pranë ARrSh më datë 06.09.2019 ankim sipas afateve ligjore dhe procedurës që parashikon legjislacioni në fuqi.

Me shkresën nr 8235/2 prot, datë 12.09.2019 dërguar në rrugë elektronike në adresën info@gjoka.al ARrSh ka kthyer përgjigje mbi ankesën e paraqitur duke e rrëzuar këtë ankim e lënë në fuqi gjetjet dhe konkluzionet e dërguara nga ARrSh se **Dokumentacioni i paraqitur nga operatori Gjoka Konstruksion sha për punë të ngjashme paraqet të dhëna të rreme e të pasakta, që nuk përputhen me realitetin e punëve të kryera në objekt.**

Në lidhje me Raportin e inspektimit dhe verifikimit në terren të punëve të deklaruara gjatë procedurës së prokurimit si objekt i ngjashëm punimesh, i cili qarkullon në media, Autoriteti Rrugor Shqiptar, NUK NA KA VËNË NË DIJENI PËR ASNJË MOMENT.

Referuar vendimmarrjes së Autoritetit kontraktor-jo vetëm nuk është respektuar ligji por nga ana tjetër është cënuar rëndë siguria juridike e shoqërisë Gjoka Konstruksion sh.a, nëpërmjet kryerjes së inspektimeve të njëanshme, abuzive dhe pa ndjekur procedurat ligjore.

ARrSh ka pretenduar se një pjesë e dokumentacionit tonë përmban të dhëna të rreme, pra e thënë më qartë rezulton që të jetë i falsifikuar. "Falsifikimi" klasifikohet nga legjislacioni në fuqi si vepër penale dhe konkretisht format e ndryshme të falsifikimit parashikohen dhe dënohen nga nenet 186-192/b të Kodit Penal. Për rrjedhojë falsifikimi mund të provohet vetëm në rrugë penale. Por cuditërisht nga ana e ARrSh, megjithë detyrimin që parashikon neni 281 i Kodit të Procedurës Penale, nuk është bërë asnjë kallëzim pranë prokurorisë. Pra, dukshëm në këtë rast, nëse do të kishte të drejtë, ARrSh ka konsumuar veprën penale të "Moskallëzimit të krimit", parashikuar nga neni 300 të Kodit Penal.



Por arsyeja e vërtetë se përse ARrSh nuk ka bërë kallëzim, lidhet me faktin se një hetim nga prokuroria do të provonte që në këtë procedurë nuk ka asnjë falsifikim të Formularit të Vlerësimit të lëshuar për nënkontraktorin Gjoka Konstruksion sh.a, Situacionit përfundimtar të punimeve dhe Akt kolaudimit të punimeve dhe për rrjedhojë do të hetohesh ajo vetë për veprën penale të "Kallëzimit të rremë", parashikuar nga neni 305 i Kodit Penal.

Këto konkluzione bazohen edhe në procedurën që ARrSh ka ndjekur, ku ndër të tjera shprehet se ka pasur edhe ankim nga një subjekt kundrejt shoqërisë "Gjoka Konstruksion" sha. Por në procedurën e ndjekur nga ARrSh nuk rezulton që të jenë marrë në konsiderate parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative (ligji nr.44/2015), akt juridik ky i cili na jep neve si palë shumë të drejta procedurale gjatë një hetimi administrativ, të cilat nuk rezulton që të jenë marrë në konsideratë nga ana ARrSh në këtë procedurë administrative.

Operatori tjetër ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, Bashkimi i Operatorëve Ekonomik, "Ircop" S.p.a & "Sulova Ndërtim Prodhim" & "Vega" & "A&E Engineering", ka të drejtë që të ankohet dhe mbi këtë bazë në përputhje me parashikimet e neneve 41 dhe 44 të nisë një procedurë administrative pranë Autoritetit Kontraktor. Por, në këtë rast, sipas nenit 82, pika 1 të K.Pr.A rezulton se në rastin e procedurave administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë.

Në përputhje me parashikimet e kësaj dispozite rezulton se BOE kishte detyrimin që të paraqiste provat e saj se ku mbështeste pretendimin në lidhje me dokumentacionin e paraqitur nga ana e shoqërisë "Gjoka Konstruksion" sha. Edhe nëse këto prova janë shfaqur nga BOE, nga ana e ARrSh si institucion ato nuk përmenden aspak dhe për më tepër nuk tregohet se ku mund të aksesojmë provat e paraqitura nga ky BOE. Nga ana ARrSh nuk na është vënë në dispozicion qoftë edhe vetëm kërkesa/ankesa që ka paraqitur BOE. Theksojmë se ky informim është një detyrim i ARrSh i cili buron nga neni 45, pikat 1 dhe 2 i K.Pr.A, ku ndër të tjera përcaktohet e drejta për t'u njohur me dokumentat e dosjes si edhe sigurimi i kushteve të nevojshme për t'u njohur me to.

Duke mos na u dhënë kjo mundësi ne e kemi pasur të pamundur që të japim mendimet, shpjegimet, komentet apo parashtrimet tona. Pra, duke mos na vënë në dispozicion asnjë provë e paraqitur nga ana e BOE, ose të na njoftoj vendi se ku mund t'i aksesojmë ato, ne na është mohuar mundësia që të mbrohemi. Është e qartë se përse ARrSh nuk ka dashur që ne të mbrohemi.

Gjithashtu nga ana ARrSh nuk janë respektuar edhe një sërë detyrimesh të tjera. Më konkretisht, nuk janë respektuar kërkesat e nenit 42 të K.Pr.A, për njoftimin tonë si palë, sebashku me të gjitha të dhënat e parashikuara në të. Vecanërisht e rëndë për të drejtat tona, kishte një rëndësi të jashtëzakonshme që të ishte përcaktuar dhe informacioni për të drejtën e njohjes së dosjes dhe zyrën ose vendin ku mund të njihet dosja (neni 42/2, gërma "ç"). Përkundrazi, ARrSh e ka zhvilluar të gjithë procedurën pa na njoftuar aspak për fillimin e saj dhe pa na



dhënë mundësinë për të paraqitur qendrimin dhe komentet tona në lidhje me procedurën administrative dhe veprimet që ka kryer deri në këto momente.

Për arsyet e mësipërme rezulton që të jenë cënuar dhe nenet 47 dhe 48 të K.Pr.A. Sipas nenit 47, "Gjoka Konstruksion" sha si palë ka të drejtë që si për kërkesën e BOE ashtu edhe për procedurën tjetër të iniciuar kryesisht nga ARrSh, në çdo fazë të paraqiste mendimet dhe komentet e saj. Duke na u mohuar kjo e drejtë dhe duke na njoftuar mbasi ishte marrë vendimi, rezulton se nga ARrSh është kryer shkelje e procedurës dhe janë mohuar të drejtat ligjore të shoqërisë Gjoka Konstruksion sha, pasi është njoftuar vetëm në fund të kësaj procedure. Për rrjedhojë në këtë rast ARrSh ka shmangur dhe detyrimin që parashikon neni 48 i K.Pr.A.

Ka qënë e dukshme tendenca e Autoritetit Rrugor Shqiptar që i konsideron mundësitë e ARrSh të pakufizuara për të "verifikuar", cdo gje në cdo kohë, por nga ana tjetër "harron" që në cdo fazë të procedimit administrativ edhe "Gjoka Konstruksion" sh.a si palë, ka patur të drejtën legjitime që të bënte komente dhe të kërkonte shpjegime.

Gjithashtu nga ana e ARrSh nuk rezulton aspak se cfarë provash ka administruar dhe mënyrën e marrjes së tyre. Kjo mënyrë e të vepruarit dukshëm bie në kundërshtim me parashikimet e nenit 80 të K.Pr.A, si edhe të nenit 25 të Ligjit nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar. Më konkretisht neni 80 pika 2 e K.Pr.A, parashikon se *Dispozitat e parashikuara në ligjin për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative mbi mjetet e provave zbatohen për aq sa është e mundur në procedurën administrative, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Kod.* Bazuar në këtë dispozitë rezulton se neni 25 i ligjit nr.49/2012 ndër të tjera parashikon se *Palët, brenda 3 ditëve nga njoftimi i vendimit, mund të paraqesin pretendimet e tyre me shkrim në lidhje me paanshmërinë, njohuritë e posaçme të ekspertit në fushën përkatëse dhe të kërkojnë përjashtimin e tij, kur janë kushtet e përcaktuara në nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile.* Bazuar në këto dispozita qartazi rezulton se:

- a) nga ana e ARrSh nuk na është njoftuar vendimi për caktimin e ekspertëve që do të verifikonin zërat e punimeve të kryera nga ana jonë.
- b) për rrjedhojë, Gjoka Konstruksion sh.a nuk ka pasur mundësi që të ngre pretendime në lidhje me paanshmërinë e ekspertëve, konfliktin e interesit apo dhe me thelbësore njohuritë e tyre në këtë fushë. Kjo e fundit merr një rendësi thelbësore duke pasur në konsideratë moshën e re të nëpunësve të ARrSh që kanë kryer inspektimin Zj. Sonila Qato ka nxjerr Urdhërin Nr.192 date 13.08.2019 për verifikim të zbatimit të punimeve të kontratës të dorëzuar si eksperiencë e ngjashme nga Gjoka Konstruksion sh.a. Ky urdhër nuk është komunikuar në kohë ndërkohe që inspektimi nga grupi i punës është kryer respektivisht në datat 13.08.2019, 14.08.2019 dhe 15.08.2019 në shkelje të procedurave, joprofesionalisht dhe hajdutshe. Përvoja profesionale e përfaqësuesve ne grupin e punës për inspektim, arkitekte dhe juriste, të cilët kishin një moshë mestare 24 vjec dhe ne përputhje me ligjin, nuk



plotësonin asnjë kriter për të pasur as licensa profesionale ne mbikqyrje dhe kolaudim punimesh për ndertime civile tunele, angazhim të cilin kishin marrë përsipër të realizonin. Nga verifikimi i punimeve në objekt Grupi i punës "me duar në xhepa" i cili ka inspektuar vetëm me sy të lirë, pa asnjë dokumentacion me vete në objektin që inspekton, pa projekt, situacion apo detaje teknike, pa marrë apo kërkuar asnjë mostër/kampion apo informacion nga ne dhe përfaqësuesi i Inxhinierit të Pavarur që i shoqëronte, ka dalë në konkluzionin se ka zëra punimesh, të cilat janë pasqyruar në situacionin përfundimtar si të përfunduara, por që në fakt janë të porealizuara dhe punimet në tunele vijojnë akoma. Nga dokumente të vëna në dispozicion nga ARrSh medias, rezulton se me datë 19.08.2019 Drejtori i ARrSh Sonila Qato ka nxjerr Urdhërin Nr.192/1 date 19.08.2019 pasi përbërja e Grupit të parë linte për të dëshiruar, dhe ky fakt i ishte bërë më dije zyrtarisht nga ne. Po nga dokumentat zyrtare të ARrSh të dala dhe botuar në shtyp rezulton sipas Raportit nr2, nr 7760/1 prot, datë 22.08.2019 se konkluzioni i përfshirë ne formularin e vlerësimit të lëshuar për nënkontraktorin Gjoka Konstruksion sh.a, situacioni përfundimtar dhe akt kolaudimi përmbajnë të dhëna fiktive, jo reale dhe që në fakt nuk përputhen me realitetin, me zërat dhe volumet reale të punimeve të kryera në terren deri në datën e inspektimit. Edhe ky Grup pune ka inspektuar në të njëjtën formë si grupi i parë (arkitekthe e juste): vetëm me sy të lirë, pa asnjë dokumentacion me vete në objektin që inspektojn, pa projekt, situacion apo detaje teknike, pa marrë apo kërkuar asnjë mostër/kampion apo informacion nga ne apo përfaqësuesi i Inxhinierit të Pavarur. Flagrante është që në Raportin nr. 2, nr. 7760/1 prot, datë 22.08.2019 të transmetuar në media, grupi i punës ka arritur në konkluzione edhe për punimet e kryera në Tunelin 6, pavarësisht se ky grup pune nuk ka hyrë asnjëherë në kantierin e Tunelit 6.

Pra, rezulton qartazi se Gjoka Konstruksion sh.a nuk është njoftuar për provat, apo ekspertët që mund të ketë caktuar ARrSh. Gjoka Konstruksion sh.a nuk ka pasur mundësi të kundërshtojë apo pranojë marrjen e tyre, nuk ka patur mundësi të bëj pyetjet e saj apo të kishte dijeni për pyetjet e bëra, konkluzionet që kanë arritur etj.

Gjithashtu Kodi i Procedurave Administrative vendos disa detyrime për organin publik, në rastin konkret të ARrSh, përpara se të marrë vendimin përfundimtar. Më konkretisht neni 87 parashikon se përpara se të merret vendimi përfundimtar, organi publik, njofton palën lidhur me të drejtën e saj për t'u dëgjuar. Në këtë rast përderisa kishte një ankesë dhe një procedurë kundër shoqërisë Gjoka Konstruksion sh.a, që lidhej me pretendime për të dhëna të rreme ARrSh kishte detyrimin që të na jepte edhe mundësinë për t'u dëgjuar. Por në kundërshtim më këtë parashikim të qartë ligjor, nga ana e ARrSh nuk rezulton që të na jenë njoftuar, 1.Nëpunësi publik përgjegjës; 2. Informacioni për të drejtën e inspektimit të dosjeve dhe zyrës dhe vendin ku kjo mund të ushtrohet; 3. Provat e administruara, rezultatet e hetimit, si dhe rezultatet e pritshme të procedurës administrative dhe motivimin përkatës dhe 4. Datën e fillimit të procedurës dhe afatin



kohor, brenda të cilit do të merret dhe njoftohet vendimi, në qoftë se një afat i tillë është i zbatueshëm.

Mosnjoftimi i këtyre të dhenave, të cilat janë detyrim i organit publik në këtë rast ARrSh, vecanërisht vendi ku mund të inspektonim dosjen përkatëse si edhe provat që kish administruar ARrSh, **kanë cënuar rëndë të drejtën tonë për t'u mbrojtur.** Praktikisht ARrSh na ka lënë në "errësirë" të hetimit.

Për më tepër, veprimet e ARrSh, duke mos ndjekur asnjë procedurë dhe duke mos u kërkuar organeve kompetente për ta ndjekur këtë rast, si dhe gjithë sa parashtruar më lart, komunikimet e bëra nga ARrSh duke referuar konkluzionet e raportit të inspektimit mbi të dhëna të rreme e të pasakta, që nuk përputhen me realitetin e punëve të kryera, nëpërmjet sistemit të prokurimit publik (me anë së cilit marrin dijeni të gjithë subjektet pjesëmarrëse në këtë procedurë prokurimit), shkresat e dërguara nga ARrSh dhe shpërndarjes së njoftimeve në media mbi falsifikim të kryer synon intimidimin e shoqërisë "Gjoka Konstruksion" sh.a dhe favorizim të BOE "Ircop" S.p.a degë e shoqërisë se huaj & "Sulova Ndërtim Prodhim" sh.p.k & "Vega" sh.p.k & "A&E Engineering" sh.p.k. Gjatë procedurës së prokurimit nëpërmjet dokumentacionit Formular Vlerësimi për punime të kryera nga nënkontraktori "Gjoka Konstruksion" sh.a, Situacionit përfundimtar të punimeve dhe Akt kolaudimit të objektit, kemi deklaruar dhe dokumentuar se janë përfunduar plotësisht 100% vetëm punime të situacionuara dhe të dorëzuara. Punimet në objekt vazhdojnë, vazhdojnë zëra punimesh të tjerë të zbatohen. Gjoka Konstruksion sh.a nuk është shprehur në asnjë pjesë të dokumentacionit të saj se tunelet dhe Rruga e Arbrit kanë përfunduar plotësisht. Është kryer kolaudim i punimeve të situacionuara dhe të realizuara nga "Gjoka Konstruksion" sh.a si nënkontraktor. Por drejtoresha e ARrSh me veprimet e saj, ka favorizuar BOE pjesë e së cilës është "Ircop" S.p.a Degë e shoqërisë së huaj një shoqëri e krijuar enkas për këtë tender nëse do të shikohet data e regjistrimit të saj në QKB më 09.05.2019 dhe konvertimi i licencës 2 javë përpara datës së tenderit, pasi asnjë shoqëri tjetër e këtij bashkimi nuk dispononte eksperiencë në ndërtim tunelesh. Oferta që synon drejtoresha e ARrSh të nxjerrë fituese me mbi 500 milion lek rëndon mbi xhepat e shqiptarve, ndaj drejtoresha e ARrSh duhet të gjente një mjet për skualifikimin tonë duke e përligjur këtë shumë.

I Nderuar z. Prokuror,

Referuar rrethanave të cituara më sipër, çmojmë se nga ana e zj. Sonila Qato me detyrë Drejtor i pergjithshem i ARrSh me veprime të drejtpërdrejta dhe me dashje direkte, janë konsumuar elementët e veprës penale të "Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike" dhe "Shpërdorimit të detyrës" parashikuar nga neni 258 dhe 248 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë:

"- Kryerja nga personi i ngarkuar me funksione shtetërore apo në shërbim publik i veprimeve në kundërshtim me ligjet që rregullojnë lirinë e pjesëmarrjes dhe



barazinë e shtetasve në tendera dhe ankande publike, për të krijuar avantazhe ose privilegje të padrejta për të tretët, dënohet me burgim gjer në tre vjet”

-Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën veprë tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet’

Për të pasur një figurë konkrete të veprës penale është e domosdoshme ekzistenca e të gjithë elementëve përbërës të saj, të marra së bashku, të cilët janë:

- a. objekti i veprës penale;
- b. ana objektive;
- c. subjekti
- d. ana subjektive.

Provueshmëria e elementëve objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale, shërben si bazë për të vënë një person përpara përgjegjësisë penale. Gjithashtu, vepra penale paraqet në vetvete një unitet të të gjithë elementëve të figurës së saj. Ajo konsiderohet e kryer dhe autori i saj mban përgjegjësi penale kur ekzistojnë të katër elementët e saj.

Objekt i veprës penale të parashikuar nga neni 258 dhe 248, janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar lirinë e pjesëmarrjes dhe barazinë e shtetasve në tendera dhe ankande publike të mbrojtura posacërisht në legjislacionin penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

Nga ana objektive, krimi kryhet nëpërmjet krijimit të avantazheve ose privilegje të padrejta për të tretët. Pra vepra penale kryhet me veprime aktive të kundraligjshme që shprehen nëpërmjet avantazhimit dhe privilegjimit të të tretëve.

Subjekt i krimit mund të jetë cdo person që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe është i përgjegjshëm, dhe kryen një funksion publik.

Nga ana subjektive, krimi kryhet me dashje të drejtpërdrejtë nga subjekti i posacem.

Vepra penale e “Shkeljes së të barazisë së pjesëmarrësve në tenderë apo ankande publike”, parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal, nisur nga vet formulimi i kësaj dispozite kuptohet qartë se për të pasur këtë figurë krimi kërkohet që nga tërësia e veprimeve në kundërshtim me ligjin që rregullojnë lirinë e pjesëmarrësve dhe barazinë në tenderë dhe ankande publike të jenë krijuar avantazhe ose privilegje të padrejta për të tretët, fakt ky që del i pasqyruar saktë në parashtrimet e mësipërme dhe dokumentacionet bashkëlidhur.

Perfundimisht, te bindur se subjekti „Gjoka Konstruktion“ sh.a dhe vete shteti kane pesuar nje dem te madh ekonomik prej veprimeve arbitrare te shtetases Sonila Qato, ne mbeshtetje te Nenit 283 te K.Pr.Penale i drejtohem i organit te akuzes duke i kerkuar:

-Ndjekje penale per :

